



Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Komuna e Mamushës

31 Dhjetor 2010

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorëve të Pavarur	1
Të Përgjithshme	6
Të Gjeturat e Vitit Aktual	7
Vazhdimi i Gjetjeve të Vitit të Kaluar	17
Forma të ndryshme të Opinioneve të Auditimit të përdorura nga Zyra e Auditorit Gjeneral në Raportin e Auditimit për vitin 2010	21
Pasqyrat Financiare për fundvitin deri më 31 Dhjetor 2010	24
Politikat Kontabël	26

Raporti i Auditorëve të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000
Pristina
Kosovo
T +381 38 247 771
+381 38 247 801

Për Kryetarin e Komunës Mamushë, Kosovë

Raport i Pasqyrave Financiare

Ne ishim të angazhuar në auditimin e pasqyrave përcjellëse të Komunës së Mamushës, ("Komuna"), që përbëhen nga pasqyra e pranimeve dhe pagesave për fund vitin më 31 Dhjetor 2010, Raporti iekzekutimit të buxhetit dhe përmbledhjet të politikave të rëndësishme dhe informata tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar nën Kontabilitetin e Parasë së gatshme", me udhëzimin administrativ Nr. 16/2010 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore dhe me udhëzimin administrativ Nr. 15/2009, 18/2009 dhe 21/2009, dhe kontrole të tilla të brendshme të cilat i përcakton menaxhmenti si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimit ose gabimit.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim opinion mbi këto pasqyra financiare në bazë të auditimit të kryer në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, për shkak të ngjarjeve të përshkruara në paragrafin e Mohimit të Opinionit, megjithatë, ne nuk ishim në gjendje të marrim evidencë të përshtatshme e të mjaftueshme të auditimit në mënyrë që të japim një bazë për opinionin e auditimit.

Baza e Mohimit të Dhënies së Opinioneve

1. Komuna nuk e mban listën e pagesave të palëve të treta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në sistemet operative dhe të kontabilitetit për pagesat e palëve të treta, si dhe për shkak të mungesës së kontrolleve alternative të implementuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryejmë teste të mjaftueshme dhe të përshtatshme që të verifikojmë kompletueshmërinë e pagesave nga palët e treta të njohura për fund vitin më 31 Dhjetor 2010.
2. Më 31 Dhjetor 2010 Komuna nuk ka shpallur llogaritë e arkëtueshme lidhur me tatimin në pronë, tatimin në licencat e biznesit dhe të arkëtueshme tjera nga tatimet që kërkohet nga udhëzimin administrativ 16/2010. Me tepër, Komuna nuk mbanë regjistrimet e plota të detyrimeve. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të aplikojmë procedura standarde dhe alternative si dhe të bindim veten me ekzistencën e llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2010.
3. Siç është shpallur në notën 11 të pasqyrave përcjellëse financiare dhe llogarive të tatimeve me vlerë prej 753 mijë euro. Nuk na janë ofruar dokumente mbështetëse në lidhje me këtë shpallje. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të përdorim procedura standarde dhe alternative të bindim veten me natyrën e shpalljes të paraqitur më 31 Dhjetor 2010.

Mohimi i Dhënies së Opinioneve

Për shkak të rëndësisë së çështjeve të trajtuara në paragrafin e Bazës për Mohim të dhënies së Opinioneve ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të duhur që të mund të japë bazë për një opinion auditimi. Prandaj, ne nuk shprehim opinion mbi pasqyrat financiare.

Theksimi i çështjes

Ne i kushtojmë vëmendje çështjeve në vijim:

Mangësitë dhe pasiguritë lidhur me raportimin financiar për pronat, objektet dhe pajisjet e Komunes janë identifikuar si më poshtë:

- Pasqyrat Financiare të Komunes për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010 siç janë shpallur në shënimin 27, prona, pajisjet dhe impiantet nuk janë rakorduar me regjistrin e aseteve. Komuna nuk ka regjistruar pronën, patundshmërinë dhe impiantet në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (referuar si “SIMFK”).
- Si pasojë e mungesës së dokumentacionit mbështetës për vlerësimin e një pjese të rëndësishme të pronave, pajisjeve dhe impianteve, Komuna bëri matjen e këtyre zërave me vlerën e drejtë bazuar në vlerësimin e bërë nga një komision i krijuar brenda saj. Komisioni nuk ishte i përbërë nga vlerësues të certifikuar dhe vlerat e raportuara në pasqyrat financiare nuk mbështeten nga ndonjë raport vlerësimi bazuar në udhëzimin administrativ 21/2009.
- Komuna nuk ka shpallur pronën, pajisjet dhe impiantet në kategorinë e cila kërkohet në udhëzimin administrativ nr 21/2009 neni 4, paragrafi 6 nga pika 6.1-6.14.

Raporti në kërkesat tjera Ligjore dhe Rregullative

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjitha aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzion për Përputhshmërinë

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë auditimit, janë në të gjithë aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje tjera

Ne tërheqim vëmendjen si më poshtë:

- a) Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK. Komuna nuk ka implementuar një program të integruar kompjuterik kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacionin për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë.

- b) Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës, dhe nuk mban lista apo llogari të veçanta për të gjithë debitorët e saj për detyrime të lidhura me taksa të ndryshme. Vetëm arkëtimet në para të gatshme nga të hyrat regjistrohen. Kjo mund të ketë ndikim në të hyrat që Komuna mund të fitoj, përgaditjen e një buxheti të besueshëm dhe të sigurt, të raportoj shkallë të besueshme të mbledhjes, dhe monitorimin e mbledhjes së të hyrave vetanake në kohë të duhur.
- c) Ne kemi identifikuar një numër të shkeljeve me Ligjin Nr. 02/L-99 e nxjerr me rregulloren Nr.2007/20 e cila rrjedh nga rregullorja e prokurimit 2003/17 “Ligji Prokurimit Publik në Kosovë”. Shkelja e tillë lidhet me procedurat e kërkuara të prokurimit të cilat nuk janë të kryera dhe dokumentuara rregullisht nga Komuna.
- d) Megjithëse Komuna mund të jetë e përfshirë në raste të ndryshme të vogla legale dhe është e mundur që në të ardhmen mund të kërkojnë në një të ardhme të afërt, Komuna nuk ka dizajnuar dhe implementuar procedurë informatave komplete, të sakta dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente.

Grant Thornton

Prishtinë,
8 Prill 2011

Shtojca I

Letër Menaxhmenti

Komuna e Mamushës

Të Përgjithshme

Auditimi për vitin 2010

Grant Thornton LLC është emëruar për të ushtruar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Mamushës (“Komuna”) të përgatitura në bazat e parasë së gatshme në pajtim me SNKSP Raportimi Financiar në Bazën e Kontabilitetit në Para të Gatshme, për vitin që mbaron më 31 Dhjetor 2010.

Këshilla jonë në këtë dokument kufizohet në konkluzionet e specifikuar në vazhdim dhe e bazuar në plotësinë dhe saktësinë e fakteve të paraqitura më poshtë, supozimeve dhe prezantimeve. Nëse ndonjë prej fakteve, supozimeve apo prezantimeve të përmendura nuk është tërësisht i plotë ose i saktë, atëherë është e domosdoshme që ne të informohemi menjëherë, duke qenë se pasaktësia dhe mungesa e plotësisë mund të kenë një efekt material në konkluzionet tona. Për dhënien e këshillës sonë, ne mbështetemi në dispozitat relevante të legjislacionit aktual në Kosovë, rregullave dhe interpretimeve juridike dhe administrative të saj. Këto autoritete i nënshtrohen ndryshimeve, në mënyrë retroaktive dhe/ose prospektive dhe ndryshime të tilla mund të kenë ndikim në vlefshmërinë e konkluzioneve tona. Ne nuk do të azhurnojmë këshillat tona për ndryshimet ose modifikimet e mëvonshme të legjislacionit dhe rregulloreve, ose të interpretimeve juridike apo administrative të tyre.

Pasojat

Raporti ynë është planifikuar të përfshijë rekomandime të dobishme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e politikave të kontabilitetit dhe sistemit të kontrollit dhe kontabilitetit të Komunës si dhe në shmangien e dobësive që mund të çojnë në humbje materiale ose në gabime. Është detyrimi juaj të ndërmerri veprimet e nevojshme për korrigjimin e dobësive dhe në qoftë se ju dështoni në ne nuk do të mbajmë përgjegjësi për humbjet apo gabimet që mund të ndodhin si rezultat.

Përjashtimi i Mashtrimit

Siç kemi rënë dakord, ju gjithashtu keni pranuar që për arsye të rëndësishme në punën tonë të informacionit dhe përfaqësimeve që na janë dhënë nga Komuna, drejtuesit e saj, punonjësit apo agjentët tuaj, përveç rasteve të neglizhencës, keqbesimit ose pakujdesive të paramenduara, nuk do të na mbani përgjegjës ose fajtorë për ndonjë humbje ose të tjera pasoja në qoftë se informacioni i rëndësishëm për punën tonë na është mbajtur apo fshehur me qëllim, ose na është paraqitur në mënyrë mashtruese.

Struktura e raportit

Secila kategori e mbikëqyrjes është përshkruar në faqe të ndryshme. Për secilën mbikëqyrje, struktura është: gjetje, rreziku, rekomandimi dhe komentet e Menaxhmentit.

Të Gjeturat e Vitit Aktual

1 Përgatitja e pasqyrave financiare

Të gjeturat

Informacion parësor në të cilin Komuna mbështetet për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është SIMFK. Komuna i regjistron pranimet dhe pagesat në fleta Excel-i, të cilat nuk mund të përdoren për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet në pasqyrat financiare.

Për më tepër, informacioni në vijim që kërkohet të shpaloset në pasqyrat financiare nuk është i regjistruar në SIMFK dhe nuk është pjesë e një softueri të integruar të kontabilitetit:

- Pagesat ndaj palëve të treta;
- Faturat e papaguara (detyrimet);
- Prona, pajisjet dhe impiantet;

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë të gatshme në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion komplet, adekuat dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet për detyrimet kontingjente.

Si pasoje e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Seksioni 15. Përmbledhja e pasurive jo-financiare të Pasqyrave Financiare më 31 Dhjetor 2010 në shënimin 27 në lidhje me pronë, pajisje dhe impiante nuk janë rikonsiluar me regjistrin e aseteve;
- Komuna ka caktuar zyrtarin e certifikuar për regjistrimin e të dhënave në Sistemin e informative të Menaxhimit Financiar në Kosovë (SIMFK), por ai nuk i ka kryer të gjitha kërkesat bazuar në UA 21/2009 neni 4 paragrafi 6, pikat nga 6.1 to 6.14;
- Seksioni 11, shënimi 12.1 Të hyrat vetanake administrative nga taksat, të cilat detaje, nuk ishin shpalosur sic duhet, për shkak se nota 12.1 nuk është shpalosur në shumën prej 8 mijë sipas udhëzimit administrativ, pasi që të hyrat nga certifikatat janë regjistruar si total e jo sipas certifikatave të ndryshme.;
- Mund të ketë pagesa në shuma domethënëse nga palët e treta, për shembull kur një palë e tretë si ndonjë Ministri apo donator i huaj blen apo kontribuon me një aset për përdorim nga Komuna, e cila pasi nuk është regjistruar në “SIMFK” nuk është shpalosur as në pasqyra financiare;
- Paragrafi 16, Nota 29 Detyrimet Kontingjente nuk janë Kompletuar.

Ne ishim informuar se Mamusha pavarësisht faktit që operon si njësi pilote që nga viti 2005, ka marr statusin e Komunës në vitin 2008.

Gjetjet e Vitit Aktual (vazhdim)

Përgatitja e Pasqyrave Financiare (vazhdim)

Risku

Mangësitë në kontrollet e brendshme në lidhje me sistemin e raportimit financiar mund ta ekspozojnë Komunën ndaj rreziqeve dhe gabimeve në lidhje me:

- Plotësinë dhe saktësinë e informacionit financiar;
- Integriteti i të dhënave;
- Ruajtja e pasurive; dhe
- Mungesa e regjistrimit të pagesave nga palë të treta mund të rezultojë në pasuri/shërbime të përdorura pa qera nga palë të tjera, të ndryshme nga Komuna.

Rekomandimi

Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejtë në pasqyrat financiare.

Komentet e Menaxhmentit

- Nuk ka komente

Gjetjet e Vitit Aktual (vazhdim)

2 Menaxhimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve

Të gjeturat

Komuna mban një regjistër të pronës, pajisjeve dhe impianteve, megjithatë ky regjistër nuk është i rikonsiluar me pasqyrat e saj financiare.

Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës për matjen e pjesës më të madhe të pronës, objekteve dhe pajisjeve të saj, Komuna ka bërë matjen e zërave të tillë në vlerën e tregut bazuar në vlerësimin e bërë nga një komisioni i formuar brenda Komunës. Komisioni nuk është i përbërë nga vlerësues të certifikuar dhe vlerat e paraqitura në listë nuk janë të mbështetura me ndonjë raport vlerësimi.

Për shkak të natyrës së të dhënave të tilla, Komuna nuk ishte në gjendje të:

- Sigurojë rikonsilimin e regjistrit të pasurive me Pasqyrat Financiare.
- Sigurojë të dhëna kontabël nga Sistemin Informativ të Menaxhimit në Kosovë (SIMFK).
- Të na sigurojë rakordimin e informacionit të regjistruar në kontabilitet me tabelat e vlerësimit ose me ndonjë analize tjetër, para aprovimit të pasqyrave financiare
- Siguroj procedura adekuate dhe të mjaftueshme për efektivitetin e monitorimit për pajtueshmërinë me udhëzimin administrativ nr. 21/2009 mbi Menaxhimin e Pronës së qeverisë dhe mirëmbajë regjistrin gjithëpërfshirës të pronës, pajisjeve dhe impianteve,.
- Siguroj të dhëna kontabël në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK).

Risku

Komuna ka zhvilluar regjistër të pronës, pajisjeve dhe impianteve, por nuk i ka rikonsiluar me pasqyrat financiare. Kjo dobësi e kontrollit të brendshëm mbi këto pasuri mund të çojë deri në keqpërdorim të pasurive dhe në mos identifikimin e këtyre keqpërdorimeve në kohën e duhur. Për më tepër, menaxhmenti mund të humbasë kohë dhe përpjekje për të identifikuar detajet dhe vlerën e bartur të aseteve gjatë proceseve vendim-marrëse.

Komuna mund të mos jetë në gjendje të kontrollojë shfrytëzimin momental të pasurisë së saj nga palët e treta dhe si pasojë mund të mos i mbledh te hyrat nga qiraja nga këto patundshmëri.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve të saj dhe mungesës së vlerësimit të duhur të pasurive, Komuna mund të mos jetë në gjendje të pajtohet me kërkesat e raportimit.

Rekomandimi

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshtë:

- Rakordoj dhe mbajë regjistrin gjithëpërfshirës të aseteve me prezantimet në pasqyra financiare;
- Të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe certifikuar është e rekomandueshme dhe praktika më e mirë në raste të tilla;
- Të bëjë numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër.
- Të bëjë përpjekje në lidhje shtimin e vlerës së aseteve të kapitalizuara.
- **Komentet e Menaxhmentit**
- **Nuk ka komente**

Gjetjet e Vitit Aktual (vazhdim)

3 Të hyrat

Të gjeturat

- Sistemi i Faturimit. Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për tatimin në pronë. Për kategoritë e tjera të të hyrave për të cilat sistemi i faturimit është i nevojshëm, nuk është aplikuar. Vetëm të hyrat në para të gatshme nga këto të ardhura regjistrohen.

Dobësitë në sistemin e automatizuar—Gjatë vitit 2010 sistemi i faturimit të tatimit në pronë është i centralizuar dhe komuna nuk ka mundur të rishikojë dhe monitorojë si duhet mbledhjen e të hyrave meqë automatikisht bëhet në sistem të ri. Mund të ketë raste që klienti ka paguar tatimin në pronë, por shumat e mbledhura nuk janë regjistruar në sistem dhe klienti mund të ngarkohet me interesa edhe pse tatimi është paguar në kohë.

Sistemi i faturimit në lidhje me tatimin në pronë nuk i pasqyron gjithë faturimet dhe të arkëtueshmet më 31 Dhjetor 2010.

- Në bazë të rregullores për tatimin në pronë, të gjitha pronat e reja të identifikuara të vitit deri më 31 Mars 2010 janë ngarkuar për tërë vitin kalendarik, ndërsa pronat e identifikuara pas datës 31 Mars 2010 janë ngarkuar me tatim në vitin e ardhshëm kalendarik.

Nuk ka ndryshime të rëndësishme nga viti kaluar në lidhje me aplikimin e Asamblesë Komunale për taksa që janë të specifikuar dy zona për kategorizimin e pronës, bazuar në të cilat do aplikohet tatimi në pronë por në fakt të gjitha pronat gjatë vitit 2010 janë ngarkuar me tarifën e vetëm një zone. Kjo ka ndodhur sepse klienti ka marrë një data bazë nga Prizreni në të cilën Mamusha shfaqet si zonë e Prizrenit dhe e gjithë prona është ngarkuar me tarifë të njëjtë. Rregullorja e Komunës për tatime, ngarkesat, gjobat dhe shërbimet e ofruara nga Komuna ishte aprovuar nga Asambleja e Komunës vetëm deri 20 Nëntor 2010.

- Të hyrat nga licencat e bizneseve. Komuna nuk ka marrë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë numrin total të bizneseve aktive në Komunë. Prandaj, bizneset joaktive apo të mbyllura mund të ngarkohen, ndërsa bizneset aktive të reja nuk ngarkohen. Nuk është ndërmarr asnjë veprim nga Komuna për të konfirmuar numrin e bizneseve operative në Komunë me listën e bizneseve sipas Autoriteteve Tatimore apo Qendrës Regjistrimit të Biznesit në Ministrinë e tregtisë dhe Industrisë.
- Bazuar në udhëzimin administrativ 16/2010, deri në Dhjetor 2010 Komuna është e obliguar të raportojë Llogaritë e Arkëtueshme lidhur me tatimin në pronë, tatimin e licencave të biznesit dhe tatimet tjera të arkëtueshme.
- Rakordimi në mes të Zyrtarit të Hyrave Vetanake dhe Departamentit të Thesarit ishte bërë për tremujorin për totalin e të hyrave. Gjatë vitit 2010 ne kemi identifikuar që nuk është kryer rekordimi midis regjistrimeve kontabël, regjistrimeve të ofruara nga zyrtari i të hyrave vetanake dhe departamentet operacionale, kështu që ka diferenca kur krahasohen këto dy burime.
- Bazuar në ekzaminimet tona të burimit të dokumenteve lidhur me disa të hyra, ne kemi identifikuar diferenca me kode të ndryshme ekonomike.
- Ndarja e Detyrave – deri më Qershor 2010, të hyrat nga shërbimet e ndryshme administrative ishte mbledhur para ne dorë, pasi që shumat ishin më të vogla se 10 EUR. Punëtori ishte përgjegjës në të njëjtën kohë kryente shërbime dhe mbante regjistra për të gjitha certifikatat e lëshuara dhe shërbime tjera të kryera. Pas kësaj date paraja në dorë ishte depozituar nga një

Të gjeturat e Vitit Aktual (vazhdim)

person tjetër. Mbledhja e të hyrave nga participimi i departamentit të shëndetësisë nuk është transferuar në bankë në baza ditore.

- Të hyrat nga participimi i shëndetësisë. Komuna nuk kryen kontrole të duhura përgjatë mbledhjes së të hyrave nga participimi shëndetësisë. Nuk ishte implementuar participimi prej 0.30 euro nga lista medikamenteve esenciale siç është specifikuar ne asamblenë Komonale të rregullores së tatimeve, gjobave, dhe tarifave.

Risku

Mungesa e saktësisë dhe kompletueshmërisë së librave të llogarive të arkëtueshme do të ndikoj të hyrat e Komunës të cilat mund ti fitoj. Pa raportet e mjaftueshme, detaje, dhe regjistrime të sigurta të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatitë buxhet të besueshëm dhe të sigurt, as për të raportuar raportin e shkallës së mbledhshmërisë, as për të vazhduar mbledhjen e të hyrave në baza kohore. Si rrjedhojë, mbledhja e ulët e të hyrave do të ndikon kapacitetin investiv të Komunës.

Kontrolli jo i duhur dhe jo i mjaftueshëm lidhur me të hyrat dhe lidhur me sistemin softuerik të faturimit rritë rrezikun e manipulimit të të dhënave dhe keqpërdorimin e informacionit. Një sistem i tillë mund të çoj në faturim dhe të hyra te pakompletuara.

Regjistrimi manual dhe mungesa e ndërveprimit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit ekspozon Komunën në rreziqe shtesë të gabimeve. Për më tepër, shkakton kosto për regjistrimin, mbajtjen, rishikimin dhe rakordimin e informative..

Lista e detajuar dhe azhurnuar e pagesve individual të tatimeve, bizneseve aktive dhe lista e debitorëve të gjeneruar nga sistemi është veçanërisht e rëndësishme në situatën e tanishme ku Komuna nuk regjistron çdo transaksion individual në SIMFK. Si pasojë, përveç tatimit në pronë, Thesarit dhe Komunës nuk u ofrohen lista me detaje nga sistemi kontabilitetit apo sistemi i faturimit. Si rezultat, nuk është e mundur të kryhet rakordimi i duhur apo analiza sipas debitorëve.

Rekomandim

Ne rekomandojmë Kryetarin të sigurohet që Komuna të ndërmer hapa të përmirësojë sistemin e faturimit dhe kontabilitetit në mënyrë që të sigurojë kontroll të sigurt, eficient dhe efektiv në faturimin dhe të hyrat. Përmirësimi i procedurave lidhur me sistemin e tillë do ti mundësonte Menaxhmentit të monitoroj dhe menaxhoj rreziqet e rëndësishme, dhe të siguroj që vendimet lidhur me buxhetin, planifikimin dhe mbledhja e të hyrave bëhen në mënyrë të duhur. Ne rekomandojmë Komunës që:

- Të implementojë sistemin e faturimit që përfshinë detaje të rifreskuara në lidhje me pagesit, adresat e tyre të tanishme, historinë, dhe shkallën e mbledhshmërisë. Në informacionin e tillë duhet të kenë qasje vetëm një numër i limituar i personelit dhe me autorizim të Menaxhmentit.

Të gjeturat e Vitit Aktual (vazhdim)

Të Hyrat (vazhdim)

- Të regjistroj dhe të kontrolloj tarifatat e aprovuara dhe shkallët tatimore në sistem në mënyrë që të kalkuloohen dhe gjenerohen faturat automatikisht. Gjenerimi i faturës gjithashtu të autorizohet dhe rishikohet.
- Ndërlidh automatikisht sistemin e faturimit me sistemin e softuerit të kontabilitetit ashtu që informacioni procesohet automatikisht në librin kryesor.
- Kryej rakordime të rregullta midis dy sistemeve për të gjitha llojet e të hyrave. Çfarëdo diference duhet të largohet me përpikëri dhe shlyhet në baza kohore.
- Në i sugjerojmë Komunës të ndërmerr veprime dhe të bëjë përpjekje të fut sistemin e centralizuar të faturimit po ashtu edhe për klientët pas datës 31 Mars të vitit aktual. Futja e shënimeve në dhe kontrolli i centralizuar përgjatë tarifave të aprovuara dhe shkallëve tatimore në sistem duhet gjithashtu të krijohet në mënyrë që të kalkuloohen dhe gjenerohen faturat automatikisht. Gjenerimi i faturave duhet të autorizohet dhe rishikohet.
- Të lidhet automatikisht njësinë operacionale me faturimin dhe kryerja e reconcilimeve të rregullta në mes tyre, në rastet kur faturimi lidhet drejtpërdrejt me shërbimet e ofruara nga njësinë operacionale. Kjo është posaçërisht e rëndësishme kur ekzekutohet numri i madh i transaksioneve.
- Ne sugjerojmë Komunën të mbanë komunikim të përhershëm me qendrën e regjistrimit të bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë lidhur me bizneset të cilat operojnë në Komunë dhe të ngarkohen për tatimet e përshkruara sipas Ligjeve dhe Rregulloreve.
- Siguroj ndarjen e duhur të detyrave.

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

Të gjeturat e Vitit Aktual (vazhdim)

4 Shpenzimet

Të Gjeturat

Mallrat dhe Shërbimet

Bazuar në auditimin tone të transaksioneve dhe aktiviteteve brenda kësaj kategorie ne identifikuam parregullsitë e në vazhdim:

- Shpenzimet e paguara për festivalin Tomato me vlerë prej Euro 6,624 (fatura 60/a) dhe Euro 8,120.6 (fatura 62/a) ishin regjistruar në kodin ekonomik 31900 si shpenzime kapitale. (Kontrata nr. 626/10/016/121).
- Shpenzimet e bëra për pastrim dhe mirëmbajtjen e rrugëve në vlerë prej Euro 472.35; 472.35; 472.35; 472.35 (shuma totale Euro 1,889) ishin regjistruar në kodin ekonomik 31900 si shpenzime kapitale, në vend të 14030 - mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore.
- Shpenzimet e bëra për furnizime të mobilieve fatura Nr . 14058 në vlerë prej Euro 3,499.89 ishin regjistruar në kodin ekonomik nr. 31690 si pajisje tjera në vend të kodit ekonomik 31620 nëse shpenzimet janë më të mëdha se Euro 1,000.00 Kontrata nr.(626/10/007/136).
- Nuk na është ofruar dokumentim komplet, duke përfshirë edhe agjendën e vizitave, për shpenzimet e bëra për ushqime biznesi në vlerë prej Euro 294 (fatura nr. 134724); Euro 425 (fatura nr. 75); Euro 460 (fatura nr. 6/10) dhe shpenzimet për akomodim të pesë mysafirëve nga Turqia në vlerë prej Euro 560 (Fatura nr.76), si dhe udhëtimet e zyrtarëve komunal jashtë vendit, p.sh shpenzimet e bëra me vlerë prej 230.20.

Risku

Mungesa e dokumenteve mbështetëse dhe pagesave të bëra nga kodet joadekuate mund të çoj tek shkelja e Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësisë ("LMFPP") nr.03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ të Thesarit 02/2009, dhe keqpërdorimit të parasë publike dhe pasqyra financiare të pasakta.

Rekomandimi

Komuna duhet të jetë në dijeni dhe të ketë kujdes të bëjë pagesa nga kodet adekuate ekonomike në mënyrë që të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësisë ("LMFPP") nr.03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ të Thesarit 02/2009. Për më tepër, të gjitha pagesat duhet të kenë dokumente mbështetëse origjinale.

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

Pagat

Të Gjeturat

Bazuar në ekzaminimin e dosjeve të punëtorëve ne gjetëm që disa dosje nuk janë të kompletuara me të gjitha dokumentet, si ne vijim:

- Vlerësimi i intervistës së pranimit

Të gjeturat e Vitit Aktual (vazhdim)

- Vlerësimi i raportit të punës së bërë në fund të vitit
- Vlerësimi i nevojave të trajnimit
- Certifikatat e trajnimit dhe kurseve
- Komuna nuk mban lista pagash mujore që përmbajnë të gjithë punëtorët në mënyrë që të bënë rakordimet e duhura me pasqyra financiare.
- Në fund të vitit 2010, punëtorët e Komunës pranuan pagesa shtesë, të cilat ishin nga Vendimi i Ministrisë së Shërbimeve Publike me emër “për mëditje”. Honorari dhe pagesat tjera e të mëditjeve të pranuar nga punëtorët ishin regjistruar në kodin e njëjtë të pagave. Sipas rregullores së planit kontabël për buxhetin e komunës, ekziston kodi specifik që është 11200, i dedikuar për honorarët dhe pagesat tjera si shtesa prej pagave të rregullta..

Risku

Mungesa e dokumenteve mbështetëse dhe pagesave të bëra nga kodet ekonomike joadekuate mund të çoj në mospajtueshmërinë me Ligjin apo kërkesat kontraktuale, keqpërdorimin e parasë publike dhe pasqyra financiare të pasakta.

Rekomandimi

Komuna duhet të krijoj kontrole dhe procedura adekuate dhe te mjaftueshme për monitorimin efektiv përgjatë pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret aplikative.

Komentet e Menaxhmentit

Procedurat e Prokurimit

Të Gjeturat

Bazuar në ekzaminimin e dokumenteve burimore lidhur me procedurat e tenderit të aplikuar në Komunë ne kemi identifikuar disa parregullsi:

- Anëtarët që ishin nominuar për pranimin teknik të punës për projektin “Shtrimi i rrugës në Mamushë” nuk posedonin kompetenca teknike profesionale (Prokurimi nr. 626-10-004-521). Për më tepër, personi që ishte nominuar në komitet për pranimin teknik, ishte në të njëjtën kohë përgjegjës si zyrtarë i shpenzimeve në Komunë.

Risku

Mungesa e stafit teknik profesional i përfshirë në procedurat e tenderimit mund të ekspozoj Komunën në rrezikun e humbjeve të mëdha.

Megjithëse gjetjet e mësipërme nuk kanë ndikim material në pasqyrat financiare, mungesa e komunikimit me kohë dhe aprovimi nga autoritetet apo dokumentimi i pakompletuar në dosjet e prokurimit mund të çoj në mos-pajtueshmërinë me ligjin dhe kërkesat rregulative.

Të gjeturat e Vitit Aktual (vazhdim)

Rekomandim

Komuna duhet të ketë stafin e tyre teknik profesional apo të angazhoj nga jashtë staf profesional në projekte të caktuara në mënyrë që të certifikon kualitetin siç përcaktohet në kërkesat e Komunës. Ne i rekomandojmë Kryetarit që të siguroj që Komuna të ndërmer hapa të mëtutjeshme të kontrollit përgjatë shpenzimeve dhe pagesave dhe të ketë pajtueshmëri strikte me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

Subvencionet dhe Transferet

Të Gjeturat

Komuna nuk ka politika të shkruara për subvencionet, që do të përmbanin kritere dhe procedura për lejimin e subvencioneve, kështu që subvencionet lejohen në bazë të vendimit të kryetarit të Komunës.

Bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.042-10, shuma prej Euro 350.00 ishte paguar për SH.H. "Shpresa Jone"-Suhareke. Pagesa ishte kryer për udhëtime të nxënësve në qytetin Përmet në Shqipëri për të marr pjesë në projektin "Naimi dhe Kombi" më datën 25 Maj 2010. Nuk na janë ofruar dokumente të kompletuara mbështetëse për këtë subvencion (agjenda e numrit të nxënësve që kanë marr pjesë në këtë ngjarje).

Risku

Mungesa e komunikimit me kohë dhe aprovimet nga të autorizuarit apo dokumentimi i pakompletuar mund të çoj në mos pajtueshmëri me Ligjin dhe Kërkesat kontraktuale dhe humbje domethënëse.

Rekomandimi

Komuna duhet të themeloj procedura të kontroleve adekuate të mjaftueshme për monitorimin efektiv në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret aplikative.

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka

1 5 Auditimi i brendshëm

- Komuna nuk ka krijuar një Komitet Auditimi dhe një funksion të Auditimit të brendshëm. Asnjë veprim nuk është ndërmarrë nga përgjegjësit për të adresuar këtë çështje e cila ishte raportuar vitin e kaluar në raportin tonë të auditimit të vitit kaluar.

Risku

Mungesa e funksionit të komitetit të Auditimit të Brendshëm rritë rrezikun e dështimit në kontrollet e brendshme. Më tepër, nuk lejohet zakonisht për funksionin e nga Komiteti i Auditimit të kryhet me pavarësi të duhur.

Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të siguron që Komuna të konsideron krijimin e funksionit të auditimit dhe Komitetin e Auditimit me anëtarët që kanë përvojën e duhur të raportimit financiar

Të gjeturat e Vitit Aktual (vazhdim)

dhe kontrollit të brendshëm. Komiteti Auditimit duhet të krijoj politika dhe procedura që të sigurojnë standarde të larta të qeverisjes. Komiteti Auditimit duhet të rishikoj statusin aktual dhe propozoj veprime për përmirësimin si ne vazhdim:

- Procesin e raportimit financiar dhe kontabël të Komunës;
- Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga Menaxhmenti;
- Procesin e Auditimit të jashtëm dhe të brendshëm;
- Përputhshmërinë, raportimin dhe strukturat e kontrollit për gjithë Komunën që të sigurohet pajtueshmëria me kërkesat rregullative dhe legale;
- Plani Auditimit të brendshëm dhe përcjellja e gjetjeve të Auditimit të brendshëm.

Komentet e Menaxhmentit

Nuk ka komente

Vazhdimi të gjeturave të vitit Kaluar (vazhdim)

Të Gjeturat e Vitit të Kaluar

1 Përgatitja e pasqyrave financiare

Të gjeturat

Informacion parësor në të cilin Komuna mbështetet për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është SIMFK. Edhe pse Komuna i regjistron pranimet dhe pagesat në fleta Excel-i, të cilat nuk mund të përdoren për të përgatitur të gjitha shënimet dhe shpalosjet në pasqyrat financiare.

Për më tepër, informacioni në vijim që kërkohet të shpaloset në pasqyrat financiare nuk është i regjistruar në SIMFK dhe nuk është pjesë e një softueri të integruar të kontabilitetit:

- Pagesat ndaj palëve të treta;
- Faturat e papaguara (detyrimet);
- Prona, objektet dhe pajisjet.

Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në çështje të vogla gjyqësore dhe është e mundur që të ketë dalje të parasë të gatshme në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion komplet, adekuat dhe të besueshëm për të regjistruar provizionet për detyrimet kontingjente.

Si pasojë e mangësive të lartpërmendura, shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:

- Paragrafi 15. Përmbledhja e pasurive jo-financiare të Pasqyrave Financiare më 31 Dhjetor 2009 në shënimin 27 në lidhje me pronë, objektet dhe pajisjet nuk janë rikonsiluar me regjistrin e aseteve;
- Komuna nuk ka ende zyrtar certifikues për regjistrimin e të dhënave kontabël në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar në Kosovë (SIMFK);
- Paragrafi 11, shënimi 12.1 Të hyrat vetanake administrative nga taksat, që të hyrat administrative nga taksat në detaje, nuk është e kompletuar sipas udhëzimit administrativ, meqë të hyrat nga certifikatat janë regjistruar si total dhe jo sipas certifikatave të ndryshme të lëshuara;
- Mund të ketë pagesa në shuma domethënëse nga palët e treta, për shembull kur një palë e tretë si ndonjë Ministri apo donator i huaj blen apo kontribuon me një aset për përdorim nga Komuna, e cila pasi nuk është regjistruar në “SIMFK” nuk është shpalosur as në pasqyra financiare. Për më shumë ne nuk kemi pranuar dokumente mbështetëse të mjaftueshme për pagesat nga palët e treta të shpalosura në pasqyrat financiare;
- Paragrafi 16, Shënimi 29 Detyrimet Kontingjente nuk është kompletuar.

Ne ishim informuar se Mamusha pavarësisht faktit që ajo operon si njësi pilote që nga viti 2005, ka marr statusin e Komunës në vitin 2008. Kjo Komunë filloi përgatitjen e pasqyrave financiare ne

Vazhdimi të gjeturave të vitit Kaluar (vazhdim)

vitin 2008, ndërkohë vitet e kaluara përgatitja e pasqyrave financiare kanë qenë jo të plota. Si rezultat informatat krahasuese të vitit 2007 nuk janë audituar.

Të gjeturat

Komuna mirëmban regjistër të pronës, impianteve dhe patundshmërive, megjithatë nuk është rakorduar me pasqyrat financiare.

Për shkak te mungesës se dokumentacionit mbështetës për matjen e pjesës më të madhe të pronës, objekteve dhe pajisjeve të saj, Komuna ka bërë matjen e zërave të tillë në vlerën e tregut bazuar në vlerësimin e bërë nga një komisioni i formuar brenda Komunës. Komisioni nuk është i përbërë nga vlerësues të certifikuar dhe vlerat e paraqitura në liste nuk janë të mbështetura me ndonjë raport vlerësimi

Për shkak të natyrës së të dhënave të tilla, Komuna nuk ishte në gjendje të:

- Sigurojë rikonsilimin e regjistrit të pasurive me Pasqyrat Financiare.
- Sigurojë të dhëna kontabël nga Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar në Kosovë (SIMFK).
- Të na sigurojë rakordimin e informacionit të regjistruar në kontabilitet me tabelat e vlerësimit ose me ndonjë analize tjetër, para aprovimit të pasqyrave financiare.

2 Të hyrat

Të gjeturat

- **Sistemi i Faturimit.** Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për tatimin në pronë. Për kategoritë e tjera të të hyrave për të cilat sistemi i faturimit është i nevojshëm, nuk është aplikuar. Vetëm të hyrat në para të gatshme nga këto të ardhura regjistrohen.

Dobësitë ne sistemin e automatizuar—Gjatë vitit 2009 sistemi i faturimit të tatimit në pronë është i centralizuar dhe komuna nuk ka mundur të rishikojë dhe monitorojë si duhet mbledhjen e të hyrave meqë automatikisht bëhet në sistem të ri. Mund të ketë raste që klienti që ka paguar tatimin në pronë, por shumat e mbledhura nuk janë regjistruar në sistem dhe klienti mund të ngarkohet me interesa edhe pse tatimi është paguar në kohë.

Sistemi i faturimit në lidhje me tatimin në pronë nuk i pasqyron gjithë faturimet dhe të arkëtueshmet më 31 Dhjetor 2009.

Në rregulloren e Asamblesë Komunale për taksa janë të specifikuara dy zona për kategorizimin e pronës, bazuar në të cilat do duhej të aplikohet tatimi në pronë, por në fakt gjithë prona gjatë 2009 është ngarkuar me tarifa vetëm të një zone. Kjo ka ndodh sepse klienti ka marrë një databazë nga Prizreni në të cilën Mamusha shfaqet si zonë e Prizrenit dhe e gjithë prona është ngarkuar me tarifë të njëjtë.

- **Të hyra nga licencat e bizneseve.** Komuna nuk marrë ndonjë listë të bizneseve aktive në Komunë. Mund të ndodhë që të ndryshojnë bizneset jo-aktive ose të mbyllura dhe të mos ndryshojnë bizneset aktive ose te reja.

Gjersa kemi bërë testimin e të hyrave nga licencat e Bizneseve kemi hasur që aktvendimi për lëshimin e licencës Hakan Commerce në datën e cila është para aprovimit të rregullores për

Vazhdimi të gjeturave të vitit Kaluar (vazhdim)

taksa është ngarkuar me tarifa të reja të rregullores së re dhe jo sipas rregullores relevante në atë periudhë.

- **Ndarja e detyrave.** Gjatë 2009, të hyrat nga taksat administrative (për shërbime të ndryshme) janë mbledhur në para të gatshme pasi që të gjitha shumat që pranohen janë më të vogla se 10 Euro. Personi përgjegjës për mbledhjen e parave të gatshme është përgjegjës edhe për shpërndarjen e shërbimeve si dhe mbajtjen e regjistrit për lloje të ndryshme të certifikatave të lëshuara dhe shërbimeve tjera
- **Të hyrat nga participimi në shëndetësi.** Komuna nuk ka performuar kontroll të duhur mbi mbledhjen e të hyrave nga participimi në shëndetësi. Nuk është implementuar tarifa prej 0.30 euro participim në shëndetësi për medikamentet e listës esenciale ashtu si është specifikuar në rregulloren e brendshme për taksa dhe tarifa.

5 Shpenzimet

Të gjeturat

Pagat dhe mëditjet

Në rastet kur një mësues jep dorëheqje, duhet minimalisht një muaj para për tu njoftuar zyra e personelit dhe Ministria e Shërbimeve Publike në mënyre që të reflektohen ndryshimet në listën e pagave. Bazuar vonesa të tilla, një mësues mund të marr pagën edhe pas dorëheqjes së tij.

Procedurat e prokurimit

Në tenderin numër 626-09-031-136 “Furnizim me dru dhe thëngjill për nevojat e shkollës” janë kërkuar 111 m³ dru; megjithatë, sipas dokumentit lidhur me origjinën dhe disponueshmërinë e drunjëve, fituesi i tenderit posedonte dokumentent lidhur me origjinën dhe disponueshmërinë vetëm për 35 m³.

